

UDHËZIM
Nr. 17, datë 22.7.2024

PËR KRITERET DHE PROCEDURAT E KUALIFIKIMIT TË PUNONJËSVE
ARSIMORË

(Ndryshuar me udhëzimin nr. 6, datë 21.1.2025; nr. 12, datë 24.2.2025)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 59, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të urdhrin nr. 565, datë 5.10.2023, të ministrit të Arsimit dhe Sportit, “Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të Arsimit dhe Sportit znj. Nina Guga”, i ndryshuar,

UDHËZOJ:

KREU I
TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Dispozita të përgjithshme

1. Kualifikimi i punonjësve arsimorë organizohet në përputhje me kriteret dhe procedurat e përcaktuara në këtë udhëzim.
2. Organizimi i kualifikimit të punonjësve arsimorë udhëhiqet nga parimi i transparencës, meritokracisë dhe barazisë për situata objektive të njëjta.

Neni 2

Organizimi i procesit të kualifikimit

1. Procesi i kualifikimit të punonjësve arsimorë në sistemin arsimor parauniversitar për kandidatët e kategorisë “Mësues i kualifikuar” kryhet nëpërmjet dosjes së zhvillimit profesional të mësuesve, vlerësimit që realizohet nëpërmjet orës mësimore të hapur dhe vlerësimit me test të informatizuar, sipas lëndëve/profileve dhe niveleve përkatëse.
2. Procesi i kualifikimit të punonjësve arsimorë në sistemin arsimor parauniversitar për kandidatët e kategorisë “Mësues specialist” kryhet nëpërmjet dosjes së zhvillimit profesional të mësuesve, vlerësimit që realizohet nëpërmjet orës mësimore të hapur dhe vlerësimit që realizohet nëpërmjet projektit kurrikular në lëndën/profilin dhe nivelin përkatës.
3. Procesi i kualifikimit të punonjësve arsimorë në sistemin arsimor parauniversitar për kandidatët e kategorisë “Mësues mjeshtër” kryhet nëpërmjet dosjes së zhvillimit profesional të mësuesve dhe vlerësimit që realizohet nëpërmjet projektit kurrikular në lëndën/profilin dhe nivelin përkatës.

Neni 3

Kualifikimi për kandidatët e kategorisë “Mësues i kualifikuar”

(Ndryshuar pika 1 me udhëzimin nr. 6, datë 21.1.2025)

1. Testimi i informatizuar do të zhvillohet nëpërmjet sistemit elektronik, Sistemit të Provimit të Shtetit.
2. Zhvillimi i orës mësimore të hapur të kandidatëve të kategorisë “Mësues i kualifikuar” organizohet në shkollën përkatëse të kandidatit me një klasë të caktuar.

3. Drejtori i shkollës, në bashkëpunim me mësuesin koordinator të sigurimit të cilësisë dhe ekipin lëndor, harton kalendarin e zhvillimit të orëve mësimore të hapura dhe e miraton atë në ZVAP, sipas afateve të përcaktuara nga MAS-i.

4. Ora mësimore e hapur zhvillohet nga kandidati mësues në prani të drejtorit të institucionit arsimor, mësuesit koordinator të sigurimit të cilësisë, drejtuesit dhe anëtarëve të ekipit lëndorë.

5. Në përfundim, ora mësimore e hapur vlerësohet sipas niveleve të vlerësimit, bazuar në instrumentin e vlerësimit të orës mësimore së hapur sipas shtojcës nr. 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi dhe pjesë përbërëse e tij.

6. Rezultati i vlerësimit dorëzohet nga drejtori i institucionit arsimor në ZVAP-në përkatëse.

Neni 4

Kualifikimi për kandidatët e kategorisë “Mësues specialist”

1. Zhvillimi i orës mësimore të hapur të kandidatëve të kategorisë “Mësues specialist” organizohet në shkollën përkatëse të kandidatit me një klasë të caktuar.

2. ZVAP-ja, në bashkëpunim me drejtuesit e rrjeteve profesionale, harton kalendarin e zhvillimit të orëve mësimore të hapura dhe e miraton atë për të gjithë kandidatët sipas afateve të përcaktuara nga MAS-i.

3. Drejtuesi i rrjetit profesional siguron pjesëmarrjen e 1–2 anëtarëve të rrjetit profesional në orën mësimore të hapur të zhvilluar nga kandidati mësues, sipas kalendarit të miratuar nga ZVAP-ja.

4. Ora mësimore e hapur zhvillohet nga kandidati mësues në prani të drejtuesit dhe/ose të 1-2 anëtarëve të rrjetit profesional sipas lëndës/profilin përkatës, drejtuesit të shkollës, mësuesit koordinator të sigurimit të cilësisë.

5. Në përfundim, ora e hapur mësimore vlerësohet sipas niveleve të vlerësimit, bazuar në instrumentin e vlerësimit të orës mësimore të hapur sipas shtojcës nr. 2, bashkëlidhur këtij udhëzimi dhe pjesë përbërëse e tij.

6. Zhvillimi i projektit kurrikular në lëndën/profilin dhe nivelin përkatës për kandidatët e kategorisë së “Mësues specialist” organizohet në shkollën përkatëse të kandidatit me një klasë të caktuar.

7. Drejtori i shkollës në bashkëpunim me mësuesin koordinator të sigurimit të cilësisë dhe ekipin lëndor harton kalendarin e zhvillimit të projekteve kurrikulare dhe e miraton atë në ZVAP, sipas afateve të përcaktuara nga MAS-i.

8. Projekti kurrikular zhvillohet nga kandidati mësues në prani të mësuesit koordinator të sigurimit të cilësisë, drejtuesit dhe anëtarëve të ekipit lëndorë si dhe drejtuesit të shkollës.

9. Në përfundim projekti kurrikular vlerësohet sipas niveleve të vlerësimit, bazuar në instrumentin e vlerësimit të projektit kurrikular sipas shtojcës nr. 3, bashkëlidhur këtij udhëzimi dhe pjesë përbërëse e tij, dhe rezultati dorëzohet në ZVAP-në përkatëse.

Neni 5

Kualifikimi për kandidatët e kategorisë “Mësues mjeshtër”

1. Zhvillimi i projektit kurrikular në lëndën/profilin dhe nivelin përkatës të kandidatëve të kategorisë “Mësues mjeshtër” organizohet në shkollën përkatëse të kandidatit me një klasë të caktuar.

2. ZVAP-ja, në bashkëpunim me drejtuesit e rrjeteve profesionale, harton kalendarin e zhvillimit të projekteve kurrikulare dhe e miraton atë për të gjithë kandidatët sipas afatit të përcaktuar nga MAS-i.

3. Drejtuesi i rrjetit profesional siguron pjesëmarrjen e 1–2 anëtarëve të rrjetit profesional në projektin kurrikular të zhvilluar nga kandidati mësues sipas kalendarit të miratuar nga ZVAP-ja.

4. Projekti kurrikular zhvillohet nga kandidati mësues në prani të drejtuesit të rrjetit profesional, anëtarëve të rrjetit profesional, drejtuesit të shkollës që mbulon lëndën/profilin përkatës, mësuesit koordinator të sigurimit të cilësisë.

5. Në përfundim, projekti kurrikular vlerësohet sipas niveleve të vlerësimit, bazuar në instrumentin e vlerësimit të projektit kurrikular, sipas shtojcës nr. 4 bashkëlidhur këtij udhëzimi dhe pjesë përbërëse e tij.

Neni 6

Kriteret e pranimit për kategoritë e kualifikimit

1. Kandidatët për kualifikim (kandidatët) janë punonjësit e institucioneve arsimore parauniversitare publike dhe private, të cilët kanë diplomë në fushën e mësuesisë ose zotërojnë diploma të arsimit të lartë të ciklit të parë dhe të dytë ose të barasvlershme me to, të ngjashme ose të përafërta me fushën përkatëse të mësimdhënies në arsimin parauniversitar, si dhe kandidatët që japin lëndët e muzikës, të arteve pamore, kërcimit dhe edukimi fizik.

2. Procedurave të kualifikimit u nënshtrohen detyrimisht të gjithë mësuesit, të cilët, deri më 31 dhjetor të vitit paraardhës, plotësojnë kushtet e mëposhtme për vjetërsinë e punës në arsim:

a) Për kategorinë e kualifikimit “Mësues i kualifikuar”:

i. 3 vjet punë si mësues;

ii. *30 kredite zhvillim profesional për tre vjet*. Mësuesi çdo vit duhet të marrë 10 kredite: të paktën 50% e krediteve të ZHVP-së duhet të jenë të lidhura me aspekte metodologjike të zbatuara në fushën/profilin që mbulon; të paktën 70% e krediteve të ZHVP-së duhet të jenë në aktivitete të drejtpërdrejta; 80% e krediteve totale të ZHVP-së duhet të jenë nga aktivitetet e akredituara në nivel kombëtar;

iii. vlerësimin e performancës nga drejtori i shkollës “Mirë” ose “Shumë mirë”.

b) Për kategorinë e kualifikimit “Mësues specialist”:

i. 8 vjet punë si mësues, nga të cilat 5 vjet punë pas fitimit të kategorisë “Mësues i kualifikuar”;

ii. *50 kredite zhvillim profesional për pesë vjet pas fitimit të kategorisë “Mësues i kualifikuar*. Çdo vit mësuesi duhet të marrë 10 kredite: të paktën 50% e krediteve të ZHVP-së duhet të jenë të lidhura me aspekte metodologjike të zbatuara në fushën/profilin që mbulon; të paktën 70% e krediteve të ZHVP-së duhet të jenë në aktivitete të drejtpërdrejta; 80% e krediteve totale të ZHVP-së duhet të jenë nga aktivitetet e akredituara në nivel kombëtar;

iii. vlerësimin e performancës nga drejtori i shkollës “Mirë” ose “Shumë mirë”.

c) Për kategorinë e kualifikimit “Mësues mjeshër”:

i. 15 vjet punë si mësues nga të cilat 7 vjet punë pas fitimit të kategorisë “Mësues specialist”;

ii. *70 kredite zhvillim profesional për shtatë vjet pas fitimit të kategorisë “Mësues specialist*. Çdo vit mësuesi duhet të marrë 10 kredite: të paktën 50% e krediteve të ZHVP-së duhet të jenë të lidhura me aspekte metodologjike të zbatuara në fushën/profilin që mbulon; të paktën 70% e krediteve të ZHVP-së duhet të jenë në aktivitete të drejtpërdrejta; 80% e krediteve totale të ZHVP-së duhet të jenë nga aktivitetet e akredituara në nivel kombëtar;

iii. vlerësimin e performancës nga drejtori i shkollës “Shumë mirë”.

3. Punonjësit arsimorë, të përmendur në pikën 2 të këtij neni, që kanë mospërputhje midis vjetërsisë së punës në arsim dhe kategorisë së kualifikimit, kualifikohen për kategorinë më të ulët që nuk e kanë fituar ende.

4. Punonjësit e diplomuar në mësuesi që punojnë në ministrinë përgjegjëse për arsimin dhe në institucione të varësisë mund të përfitojnë kategorinë përkatëse të kualifikimit, nëse plotësojnë kriteret e përcaktuara në pikat 1 dhe 2 të këtij neni.

5. Kriteret e pikës 2 të këtij neni zbatohen për të gjithë kandidatët, duke filluar nga viti shkollor 2024–2025.

Neni 7

Parimet bazë të procedurave të vlerësimit me test të informatizuar

Procedura e vlerësimit të kualifikimit bazohet në parimet e mëposhtme:

- a) ruajtja e fshehtësisë së fondit të pyetjeve;
- b) korrektesa e kandidatëve në mjedisin e vlerësimit;
- c) korrektesa e administrimit;
- ç) vlerësimi i standardizuar dhe në kohë reale.

Neni 8

Parimet bazë të procedurave të vlerësimit me orë mësimore të hapur dhe/ose projekt kurrikular

Zhvillimi i orës mësimore e hapur dhe projektit kurrikular bazohet në parimet e mëposhtme:

- a) krijimtaria;
- b) risia;
- c) profesionalizmi;
- ç) gjithëpërfshirja;
- d) efektiviteti.

Neni 9

Programet orientuese të kualifikimit

1. Programet orientuese të kualifikimit të punonjësve arsimorë hartohen nga ASCAP-i dhe vihen në dispozicion të kandidatëve nga ZVAP-të.
2. Programet orientuese të kualifikimit publikohen edhe në faqen zyrtare elektronike të ASCAP-it.
3. Programi orientues i kualifikimit të punonjësve arsimorë të arsimit parashkollor bazohet në të gjitha programet mësimore të arsimit parashkollor.
4. Programi orientues i kualifikimit të punonjësve arsimorë të arsimit fillor bazohet në të gjitha programet lëndore të arsimit fillor.
5. Programet orientuese të kualifikimit të punonjësve arsimorë të arsimit të mesëm të ulët, të gjimnazit, të shkollave të specializuara, si dhe të mësuesve të kulturës së përgjithshme në arsimin e orientuar, bazohen në të gjitha programet e lëndëve që japin në shkollë.
6. Programet orientuese të kualifikimit të punonjësve arsimorë që japin lëndët profesionale në shkollat artistike, bazohen në programet mësimore për degët e muzikës, artit pamor dhe baletit.
7. Programet orientuese të kualifikimit të punonjësve arsimorë që japin lëndët e kulturës profesionale në shkollat speciale ose për mësuesit ndihmës, hartohen sipas programeve të përgatitura nga ASCAP-i.
8. Mësuesit e arsimit të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë që japin më shumë se një lëndë, do t'i nënshtrohen procesit të kualifikimit për lëndën në të cilën zhvillojnë më shumë orë mësimore vjetore gjatë vitit të kualifikimit. Për raste të veçanta është kompetencë e ZVAP-së të vendosë në cilën lëndë do të kualifikohet mësuesi.

KREU II

DETYRAT E INSTITUCIONEVE PËRGJEGJËSE DHE TË KANDIDATËVE

Neni 10

Detyrat dhe kompetencat e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar

Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar kryen detyrat e mëposhtme:

a) harton dhe publikon në faqen zyrtare të saj programet orientuese për kualifikimin sipas profileve përkatëse, të cilat përmbajnë orientime rreth njohurive dhe aftësive bazë që duhet të zotërojnë mësuesi për vlerësimin e kualifikimit për kandidatët e kategorisë “Mësues i kualifikuar”, orientime rreth formatit të orës mësimore të hapur dhe formatit të projektit kurrikular për kandidatët e kategorisë “Mësues specialist” dhe kategorisë “Mësues mjeshtër”, referencat e literaturës që përbëhen nga akte ligjore e nënligjore dhe udhëzues të institucioneve të varësisë së Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. Pjesa tjetër e literaturës përzgjidhet nga mësuesit që do të marrin pjesë në kualifikim;

b) cakton hartuesit e fondit të pyetjeve me alternativa, që do të përdoret për çdo testim sipas profileve dhe cikleve përkatëse;

c) realizon seanca informuese me specialistët e ZVAP-ve, DRAP-ve, drejtues të rrjeteve profesionale, drejtues të institucioneve arsimore parauniversitare lidhur me kriteret e vlerësimit të orëve të hapura, të projekteve kurrikulare;

ç) realizon seanca informuese me hartuesit e fondit të pyetjeve me alternativa;

d) merr në dorëzim zyrtarisht me procesverbal nga hartuesit e fondeve të pyetjeve, fondin me alternativa të çdo profili, për të cilin do të zhvillohet testimi;

dh) organizon fondin e pyetjeve nëpërmjet koordinatorit të profilit lëndor përkatës, i cili vlerëson dhe miraton saktësimin e përmbajtjes së fondit të pyetjeve, sipas kriterëve të përcaktuara nga QSHA-ja;

e) dorëzon zyrtarisht me procesverbal në QSHA fondin përfundimtar të pyetjeve me alternativa të miratuara për çdo profil lëndor, në format elektronik;

ë) përcakton strukturën përmbajtësore të testit dhe e dorëzon zyrtarisht në QSHA;

f) monitoron procesin e zhvillimit të orëve mësimore të hapura dhe projekteve kurrikulare në bashkëpunim me AKAP-in, me DRAP-të dhe me ZVAP-të;

g) përpunon të dhënat përfundimtare të ardhur nga AKAP-i për të gjithë kandidatët pjesëmarrës në procesin e kualifikimit të punonjësve arsimorë me vlerësimet përkatëse;

gj) harton raportin vjetor të kualifikimit të punonjësve arsimorë dhe ia paraqet ministrit përgjegjës për arsimin.

Neni 11

Detyrat dhe kompetencat e Qendrës së Shërbimeve Arsimore

Qendra e Shërbimeve Arsimore, lidhur me zhvillimin e testimit të informatizuar, kryen detyrat e mëposhtme:

a) merr në dorëzim fondin e pyetjeve për çdo profil testimi të miratuar nga ASCAP-i;

b) merr në dorëzim strukturën e testit që do të zhvillohet për kandidatët për çdo profil testimi;

c) digjitalizon fondin e pyetjeve për çdo profil testimi të informatizuar;

ç) harton dhe publikon kalendarin e organizimit të testimit të informatizuar, sipas profileve dhe e dërgon në MAS, në ASCAP dhe në AKAP;

d) publikon listat e kandidatëve sipas profilit, datës dhe orarit të caktuar për zhvillimin e testimit;

dh) verifikon identitetin e kandidatëve pjesëmarrës në testimin e informatizuar përmes dokumenteve përkatëse (pasaportë biometrike/kartë identiteti);

e) zbaton procedurat e zhvillimit të testimit përmes teknologjisë digjitale;

ë) siguron kushte të përshtatshme në sallat e përcaktuara për zhvillimin e testimit të informatizuar përmes teknologjisë digjitale;

f) siguron kushte të përshtatshme për kandidatët me aftësi të kufizuara fizike;

g) mban procesverbale për çdo vendimmarrje gjatë procedurave të zhvillimit të testimit të informatizuar, deri në shpalljen e rezultateve;

gj) harton raportin statistikor lidhur me rezultatet e testimit të informatizuar dhe ia paraqet ministrit të Arsimit dhe Sportit;

h) harton dhe ruan të gjithë dokumentacionin shkresor, që ka lidhje me testimin e informatizuar.

Neni 12

Detyrat dhe përgjegjësitë e Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar

Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar kryen detyrat e mëposhtme:

a) verifikon dhe monitoron saktësinë e aplikimeve të paraqitura nga kandidatët për procesin e kualifikimit të kryer nga ZVAP-ja përkatëse;

b) verifikon dhe monitoron vlerësimin e kritereve të kandidatëve për të hyrë në procesin e kualifikimit të kryer nga ZVAP-ja përkatëse;

c) monitoron vlerësimin e dosjes së mësuesit të kryer nga ZVAP-ja përkatëse;

ç) monitoron procesin e zhvillimit të orëve të hapura dhe projekteve kurrikulare në bashkëpunim me ASCAP-in, me DRAP-et dhe me ZVAP-et.

d) dërgon në ASCAP të dhënat përfundimtare për të gjithë kandidatët në procesin e kualifikimit të punonjësve arsimorë me vlerësimet përkatëse.

Neni 13

Detyrat e Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar

Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar kryen detyrat e mëposhtme:

a) verifikon dhe monitoron plotësinë dhe saktësinë e aplikimeve të paraqitura nga kandidatët për procesin e kualifikimit;

b) verifikon dhe monitoron procesin e vlerësimit të kritereve të kandidatëve për të hyrë në procesin e kualifikimit të kryer nga ZVAP-ja përkatëse;

c) monitoron vlerësimin e dosjes së mësuesit të kryer nga ZVAP-ja përkatëse;

ç) monitoron procesin e zhvillimit të orëve të hapura dhe projekteve kurrikulare në bashkëpunim me ASCAP-in, me AKAP-in dhe me ZVAP-të;

d) dërgon zyrtarisht në AKAP në formë elektronike dhe me shkresë zyrtare rezultatet e vlerësimeve të orëve të hapura mësimore dhe të projekteve kurrikulare, sipas formatit të ASCAP-it;

dh) organizon seminare rreth rezultateve të kualifikimit në DRAP;

e) përmirëson planin e zhvillimit profesional të punonjësve arsimorë mbështetur në rezultatet e vlerësimeve;

ë) dërgon në AKAP të dhënat përfundimtare për të gjithë kandidatët në procesin e kualifikimit të punonjësve arsimorë me vlerësimet përkatëse.

Neni 14

Detyrat e Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar

Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar kryen detyrat e mëposhtme:

a) informon kandidatët për procedurat dhe rregullat e procesit të kualifikimit;

b) njofton kandidatët që të paraqesin kërkesën për kualifikim në dosjen e mësuesit;

c) shqyrton dhe miraton kërkesat e paraqitura;

ç) vlerëson dosjet e kandidatëve nga komisione të ngritura në ZVAP;

d) njofton secilin kandidat dhe drejtorinë e shkollës përkatëse për vlerësimin e dosjet sipas kalendarit të dërguar nga QSHA-ja;

dh) njofton secilin kandidat për datën, mjedisin, orën e zhvillimit të testimit të informatizuar për kandidatët e kategorisë “Mësues i kualifikuar”, sipas kalendarit të përcaktuar nga QSHA-ja;

e) njofton në bashkëpunim me drejtuesin e rrjetit profesional secilin kandidat për datën e zhvillimit të orës mësimore të hapur për kandidatët e kategorisë “Mësues specialist” dhe të projekteve kurrikulare për kandidatët e kategorisë “Mësues mjeshtër”;

ë) siguron pjesëmarrjen në orën mësimore të hapur ose në projektin kurrikular të drejtuesit dhe anëtarëve të rrjetit profesional;

f) përgatit instrumentin përkatës për vlerësimin e orës mësimore të hapur ose të projektit kurrikular, i cili plotësohet dhe nënshkruhet nga përfaqësuesi i ZVAP-së, drejtuesi i rrjetit profesional dhe drejtuesi i shkollës përkatëse, si dhe firmoset nga mësuesi kandidat;

g) përgatit instrumentin përkatës për vlerësimin e orës së hapur mësimore dhe/ose të projektit kurrikular, i cili plotësohet dhe nënshkruhet nga mësuesi koordinator i sigurimit të cilësisë/kryetar i ekipit lëndor dhe drejtuesi i institucionit arsimor përkatës, si dhe firmoset nga mësuesi kandidat;

gj) mbledh të gjitha vlerësimet për orët mësimore të hapura dhe projektet kurrikulare të zhvilluara nga kandidatët e kategorisë “Mësues mjeshtër”, kategorisë “Mësues specialist”, kategorisë “Mësues i kualifikuar” dhe i ruan ato sipas legjislacionit në fuqi;

h) monitoron procesin e zhvillimit të orëve të hapura dhe të projekteve kurrikulare në bashkëpunim me ASCAP-in, me AKAP-in dhe DRAP-të;

i) plotëson databazën e rezultateve të vlerësimeve të orëve të hapura mësimore dhe të projekteve kurrikulare, sipas formatit të ASCAP-it;

j) dërgon zyrtarisht në DRAP në formë elektronike dhe me shkresë zyrtare rezultatet e vlerësimeve të orëve të hapura mësimore dhe projekteve kurrikulare, sipas formatit të ASCAP-it;

k) hedh në dosjen e mësuesit të dhënat e reja të kualifikimit të mësuesit.

Neni 15

Detyrat dhe përgjegjësitë e kandidatit të kategorisë “Mësues i kualifikuar” për zhvillimin e testimit të informatizuar

1. Ditën e zhvillimit të testimit të informatizuar, kandidati duhet të respektojë rregullat e mëposhtme:

- a) të jetë i pajisur me dokument identifikimi (kartë identiteti ose pasaportë biometrike);
- b) të paraqitet së paku 30 minuta përpara fillimit të testimit;
- c) të mos mbajë dhe të mos përdorë telefonin celular dhe mjete të tjera të komunikimit gjatë zhvillimit të vlerësimit, pasi kjo përbën kriter skualifikimi;
- ç) të mos pijë duhan dhe të mos konsumojë ushqime në mjediset e vlerësimit;
- d) të mos komunikojë me njëri-tjetrin gjatë zhvillimit të testimit të informatizuar.

2. Nëse një kandidat nuk paraqitet ose tërhiqet përpara hyrjes në sallën e testimit, testimi nuk vlerësohet si i kryer.

3. Tërheqja nga testimi i informatizuar nuk mund të kryhet pas hyrjes në sallën e testimit.

4. Kandidati që del nga salla e testimit të informatizuar, nuk rihyn në sallë deri në përfundim të tij.

Neni 16

Detyrat dhe përgjegjësitë e kandidatit për zhvillimin e orëve të hapura mësimore dhe projekteve kurrikulare

1. Kandidati realizon orën mësimore të hapur ose projektin kurrikular vetëm në ditën e përcaktuar në kalendarin e ZVAP-së ose të institucionit arsimor, duke respektuar orarin përkatës.

2. Kandidati planifikon orën mësimore të hapur ose projektin kurrikular në bashkëpunim me mësuesin koordinator për sigurimin e cilësisë/drejtuesin e ekipit lëndor.

3. Për zhvillimin e orës mësimore të hapur ose të projektit kurrikular, kandidati duhet të ketë parasysh:

- a) të përgatisë paraprakisht planifikimin e orës mësimore të hapur ose të projektit kurrikular dhe t'ua vërë në dispozicion pjesëmarrësve;
- b) të vërë në dijeni, drejtorinë e institucionit arsimor për klasën me të cilën do të zhvillojë orën mësimore të hapur ose projektin kurrikular;
- c) të përgatisë paraprakisht mjedisin e klasës ku do të zhvillohet ora mësimore e hapur ose projekti kurrikular;
- ç) të diskutojë me pjesëmarrësit mbi cilësinë dhe efektivitetin e realizimit të orës mësimore të hapur ose të projektit kurrikular.

KREU III DOSJA E KANDIDATIT

Neni 17

Dosja e kandidatit

(Ndryshuar shkronja "a" e pikës 1 me udhëzimin nr. 6, datë 21.1.2025; ndryshuar shkronja "a" e pikës 1 me udhëzimin nr. 12, datë 24.2.2025)

1. Në dosje, kandidati plotëson të dhënat e tij të zhvillimit profesional dhe ngarkon dokumentet e mëposhtme në sistemin elektronik përkatës, të cilat konfirmohen nga drejtori i institucionit arsimor dhe/ose njësia arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar:

a) Licencë për ushtrimin e profesionit të mësuesit, në profilin përkatës.

Mësuesit që janë përjashtuar nga detyrimi i provimit të shtetit, ngarkojnë diplomë në fushën e mësuesisë ose diploma të arsimit të lartë të ciklit të parë dhe të dytë ose të barasvlershme me to, të ngjashme ose të përafërta me fushën përkatëse të mësimdhënies në arsimin parauniversitar, përfshirë edhe diplomat e kandidatëve që japin lëndët e muzikës, të arteve pamore, kërcimit dhe edukimit fizik.

Mësuesit nëse kanë, ngarkojnë edhe:

i. Diplomë të ciklit të dytë master me 60–120 kredite, e cila nuk është diplomë që vlen si kriter arsimimi për profesionin e mësuesit;

ii. Diplomë të ciklit të tretë “Master ekzekutiv” ose të barasvlershme me to me 60–120 kredite;

iii. Diplomë për fitimin e gradës shkencore “Doktor” në fushën e edukimit, e drejtimit të arsimit dhe/ose që lidhet me profilin përkatës.

b) Certifikatat me kreditet përkatëse të vlefshme.

c) Dëshmi të mbrojtjes së gjuhëve të huaja (nëse ka). Gjuha e huaj e mbrojtur në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja të Universitetit të Tiranës ose në teste ndërkombëtare, të njohura sipas legjislacionit në fuqi.

ç) Vlerësimi i fundit i drejtorit të shkollës.

2. Komisioni i Vlerësimit të Dosjeve (KVD), i ngritur nga titullari i ZVAP-së, vlerëson me pikë secilin dokument të dosjes profesionale, sipas kriterëve të përcaktuara në shtojcat nr. 5 dhe nr. 6, bashkëlidhur këtij udhëzimi dhe pjesë përbërëse të tij.

3. Kandidati, që nuk i dorëzon dokumentet e kërkuara në shkronjat “b” dhe “ç” të pikës 1 të këtij neni, nuk merr pjesë në procesin e kualifikimit.

KREU IV TESTIMI I INFORMATIZUAR

Neni 18

Llojet e testeve të informatizuara të kualifikimit për kandidatët e kategorisë “Mësues i kualifikuar”

1. Testet e vlerësimit të kualifikimit janë:
 - a) testi i arsimit parashkollor;
 - b) testi i arsimit fillor;
 - c) testi i arsimit të mesëm të ulët për lëndët: gjuhë shqipe, anglisht, frëngjisht, italisht, gjermanisht, matematikë, fizikë, biologji, kimi, histori, gjeografi, qytetari, TIK, edukim fizik, muzikë, art pamor, si dhe lëndë të tjera specifike brenda planit mësimor, sipas kërkesave nga ZVAP-të;
 - ç) testi i gjimnazit dhe i kulturës së përgjithshme të shkollave të mesme të orientuara dhe speciale për lëndët: gjuhë shqipe dhe letërsi, anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, matematikë, fizikë, biologji, kimi, histori, gjeografi, teknologji informacioni dhe komunikimi, ekonomi, qytetari, sociologji, psikologji, filozofi, edukim fizik, si dhe lëndë të tjera specifike brenda sistemit arsimor, sipas kërkesave nga AKAP-i;
 - d) testi për specialitetet “Muzikë”, “Art pamor” dhe “Balet” në kulturën profesionale në shkollat e orientuara artistike;
 - dh) testi i përgjithshëm për mësuesit e kulturës profesionale në shkollat e specializuara ose për mësuesit ndihmës.
2. Një test i vlerësimit të kualifikimit përbëhet nga dy pjesë:
 - a) pjesa e parë përmban zbatimin e programeve përkatëse lëndore dhe planifikimin e lëndës, mjedisin e të nxënit, metodologjitë efektive të mësimdhënie-nxënies në përgjithësi dhe të lëndës përkatëse, vlerësimin dhe arritjet e nxënësve, aspekte të etikës, sjelljes dhe komunikimit të mësuesit në institucionin arsimor parauniversitar në mjediset e institucionit, si dhe aspekte të drejtshkrimit të gjuhës shqipe;
 - b) pjesa e dytë përfshin aspekte të zbatimit të përmbajtjes shkencore të lëndës në situata praktike nga jeta reale.

Neni 19

Hartimi i fondit të pyetjeve

1. ASCAP-i ngre grupe pune për hartimin e fondit të pyetjeve për zhvillimin e testimit të informatizuar për kandidatët e kualifikimit të kategorisë “Mësues i kualifikuar”, sipas profileve të testimit të informatizuar, me përfaqësues mësues dhe specialistë të sistemit arsimor parauniversitar.
2. Fondi i pyetjeve hartohet në bazë të standardeve të përcaktuara nga QSHA-ja dhe pyetjet grupohen, si më poshtë:
 - a) në pjesë/kapituj sipas grupeve kryesore të profileve;
 - b) nivele vështirësie: niveli 1 (i lehtë), niveli 2 (mesatar), niveli 3 (i vështirë).
3. Hartuesit kanë përgjegjësi për saktësinë e pyetjeve të hartuara nga ana e tyre.

Neni 20

Miratimi i fondit të pyetjeve të testimit të informatizuar

- Ajencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, në lidhje me fondin e pyetjeve për çdo profil, ndjek procedurat e mëposhtme:
- a) merr në dorëzim me procesverbal nga hartuesit, fondet e pyetjeve të testimit të informatizuar dhe i miraton ato;
 - b) shqyrton fondin e pyetjeve me synimin për përfaqësimin sa më të mirë të njohurive të programit, duke konsideruar:
 - i. peshën e secilës pjesë të programit që do të përfaqësohet në test dhe përputhshmërinë e pyetjeve me programin orientues të shpallur, si dhe formulimin e saktë të tyre nga ana e përmbajtjes; kur konstatohet se nuk përmbushen këto kushte, ndryshon formulimin e pyetjes duke e bërë atë të vlefshme për fondin e pyetjeve, ose e heq atë;

- ii. përcakton vështirësinë e pyetjeve duke bërë ndryshime, nëse e sheh të arsyeshme;
- iii. përgjigjet për saktësinë e fondit të pyetjeve dhe të përgjigjeve përkatëse të çdo profili;
- c) përcakton raportin në përqindje të përfshirjes së pyetjeve të ndara sipas nivelit të vështirësisë, në përputhje me karakteristikat e programit të informatizuar të QSHA-së;
- ç) i dorëzon QSHA-së fondin e miratuar të pyetjeve me alternativat përkatëse ku saktësohet përgjigjja e saktë.

Neni 21

Modalitetet e zhvillimit të testimit të informatizuar

1. Për çdo seancë testimi, pyetjet e përzgjedhura nga sistemi në mënyrë automatike janë të njëjta për të gjithë kandidatët pjesëmarrës në testimin e informatizuar.
2. Testimi i informatizuar zgjat 60 (gjashtëdhjetë) minuta dhe zhvillohet në një raund të vetëm. Ai fillon dhe mbaron njëkohësisht për të gjithë kandidatët pjesëmarrës në testim, në ditën dhe orarin e caktuar.
3. Vlerësimi i kandidatëve kryhet në mënyrë automatike nga sistemi kompjuterik në momentin e përfundimit të testimit. Rezultati i shfaqet kandidatit në monitor dhe printohet në mënyrë automatike nga sistemi së bashku me përgjigjet e dhëna. Çdo kandidat nënshkruan deklaratën sipas formatit që QSHA-ja disponon në sistem me rezultatet e testimit të printuar në përfundim të testimit përkatës.
4. QSHA-ja ka të drejtë që, në rast se evidenton shkelje të rregullave të vlerësimit, të përjashtojë kandidatin që thyen rregullat.
5. Nëse konstatohet se testimi nuk është zhvilluar sipas rregullave, atëherë për kandidatët e kësaj sale, testimi do të vlerësohet si jo i kryer. Vendimi në këtë rast është në kompetencë të QSHA-së.

Neni 22

Vlerësimi i testimit të informatizuar për kandidatët e kategorisë “Mësues i kualifikuar”

1. Teza e testimit të informatizuar përmban pyetje me alternativa, përgjigjet e sakta të të cilave vlerësohen me 100 pikë. Pikët që kandidati fiton nga testimi i informatizuar konvertohen maksimalisht në 40 pikë, duke shumëzuar numrin e pikëve që kandidati ka marrë në testimin e informatizuar me 0.4.
2. Pjesa e parë e testimit të informatizuar përmban 20 pikë dhe pjesa e dytë përmban 20 pikë.
3. Vlerësimi i testimit të informatizuar kalohet me sukses kur kandidati fiton të paktën 60 përqind të pikëve total të testit.

KREU V

ORA MËSIMORE E HAPUR DHE/OSE PROJEKTI KURRIKULAR

Neni 23

Llojet e profileve/lëndëve të orës mësimore të hapur ose të projektit kurrikular

1. Ora mësimore e hapur ose projekti kurrikular për procesin e kualifikimit ndërtohet sipas planifikimit ditor, duke përfshirë risi metodologjike për realizimin e rezultateve të të nxënit, si dhe risi në veprimtaritë e të nxënit.
2. Orët mësimore të hapura ose projektet kurrikulare për procesin e kualifikimit janë:
 - a) orë mësimore e hapur ose projekt kurrikular për arsimin parashkollor;
 - b) orë mësimore e hapur ose projekt kurrikular për arsimin fillor;

c) orë mësimore e hapur ose projekt kurrikular për arsimin e mesëm të ulët për lëndët: gjuhë shqipe, anglisht, frëngjisht, italisht, gjermanisht, matematikë, fizikë, biologji, kimi, histori, gjeografi, qytetari, TIK, edukim fizik, muzikë, art pamor, si dhe lëndë të tjera specifike brenda planit mësimor, sipas kërkesave nga ZVAP-ja;

ç) orë mësimore e hapur ose projekt kurrikular për gjimnazin dhe për kulturën e përgjithshme të shkollave të orientuara dhe speciale për lëndët: gjuhë shqipe dhe letërsi, anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, matematikë, fizikë, biologji, kimi, histori, gjeografi, teknologji informacioni dhe komunikimi, ekonomi, qytetari, sociologji, psikologji, filozofi, edukim fizik, si dhe lëndë të tjera specifike brenda sistemit arsimor sipas kërkesave nga ZVAP-ja.

d) orë mësimore e hapur ose projekt kurrikular për specialitetet “Muzikë”, “Art pamor” dhe “Balet” në kulturën e orientuar në shkollat artistike.

dh) orë mësimore e hapur ose projekt kurrikular për mësuesit e arsimit special ose për mësuesit ndihmës.

Neni 24

Administrimi i orëve mësimore të hapura ose i projekteve kurrikulare

1. ZVAP-ja dërgon instrumentin e vlerësimit të orës mësimore të hapur ose të projektit kurrikular në drejtorinë e institucionit arsimor.

2. Drejtori i institucionit arsimor i dorëzon instrumentin e vlerësimit të orës mësimore të hapur ose të projektit kurrikular drejtuesit të rrjetit profesional ose mësuesit koordinator për sigurimin e cilësisë/drejtuesit të ekipit lëndor që do të marrë pjesë në orën mësimore të hapur ose projektin kurrikular.

3. Drejtori i institucionit arsimor siguron mjedisin, mjete didaktike apo mjete (nëse ka në dispozicion) në funksion të kërkesave që parashtron kandidati për realizimin e orës mësimore të hapur ose të projektit kurrikular.

4. Drejtori i institucionit arsimor siguron pjesëmarrjen në orën e hapur ose të projektit kurrikular edhe të ekipit lëndor, si dhe/ose të një përfaqësuesi nga këshilli i prindërve të shkollës.

5. Drejtuesi i rrjetit profesional, përfaqësuesi i ZVAP-së dhe drejtuesi i shkollës ose mësuesi koordinator i sigurimit të cilësisë/kryetar i ekipit lëndor që do të marrë pjesë në orën mësimore të hapur ose në projektin kurrikular, organizojnë diskutimin me pjesëmarrësit lidhur me cilësinë, menaxhimin dhe efektivitetin e realizimit të orës mësimore ose të projektit kurrikular, si dhe plotësojnë e nënshkruajnë vlerësimin në përfundim të kryerjes së saj.

6. Drejtori i institucionit arsimor dorëzon të plotësuar në ZVAP instrumentin e vlerësimit të orës mësimore të hapur ose të projektit kurrikular të zhvilluar nga kandidatët përkatës.

7. Drejtuesit e rrjeteve profesionale, mësuesit koordinator të sigurimit të cilësisë ose kryetarët e ekipeve lëndore përfshijnë në planet vjetore përkatëse pjesëmarrjen në orët mësimore të hapura ose në projektet kurrikulare për procesin e kualifikimit të punonjësve arsimorë.

Neni 25

Vlerësimi i orës mësimore të hapur ose i projektit kurrikular

1. Vlerësimi i orës mësimore të hapur për kandidatët e kategorisë “Mësues i kualifikuar” dhe të kategorisë “Mësues specialist” bëhet sipas niveleve të vlerësimit, bazuar në instrumentet (shtojcat nr. 1 dhe nr. 2) për vlerësimin e orës mësimore me 30 pikë.

2. Vlerësimi i projektit kurrikular për kandidatët e kategorisë “Mësues specialist” bëhet sipas niveleve të vlerësimit, bazuar në instrumentin (shtojca nr. 3) për vlerësimin e projektit kurrikular me 40 pikë.

3. Vlerësimi i projektit kurrikular për kandidatët e kategorisë “Mësues mjeshtër” bëhet sipas niveleve të vlerësimit, bazuar në instrumentin (shtojca nr. 4) për vlerësimin e projektit kurrikular me 70 pikë.

4. Ora mësimore e hapur ose projekti kurrikular konsiderohet i kaluar me sukses kur kandidati fiton të paktën 60 për qind të pikëve të secilit komponent.

5. Vlerësimet për orën e hapur mësimore ose për projektin kurrikular shënohen në kolonën përkatëse të databazës që dërgohet në ASCAP për kandidatët e kualifikimit.

KREU VI PROCESI I KUALIFIKIMIT

Neni 26

Vlerësimi i procesit të kualifikimit për të gjithë kandidatët

1. Vlerësimi përfundimtar për të gjithë kandidatët bëhet me sistemin e 100 pikëve.
2. Vlerësimi për kandidatët e kategorisë “Mësues i kualifikuar” është 30 pikë të dosjes, 30 pikë të orës së hapur mësimore dhe 40 pikë të testit të informatizuar.
3. Vlerësimi për kandidatët e kategorisë “Mësues specialist” është 30 pikë të dosjes, 30 pikë të orës së hapur mësimore dhe 40 pikë të projektit kurrikular.
4. Vlerësimi për kandidatët e kategorisë “Mësues mjeshtër” është 30 pikë të dosjes dhe 70 pikë të projektit kurrikular.
5. Kandidati vlerësohet me pesë shkallë: A, B, C, D, E, që u korrespondojnë përkatësisht vlerësimeve me fjalët: “Shkëlqyeshëm”; “Shumë mirë”, “Mirë”, “Mjaftueshëm” dhe “Dobët”, sipas pikëve të përcaktuara nga ASCAP-i.
6. Kandidati nuk e fiton kualifikimin, nëse vlerësimi përfundimtar i tij është “Dobët”.

Neni 27

Përsëritja e procesit të kualifikimit

Kandidati, që është vlerësuar “Dobët” në procesin e kualifikimit për çdo kategori, hyn në procesin e sesionit pasardhës.

Neni 28

Certifikimi

Kandidati që fiton kategorinë e kualifikimit, pajiset nga ASCAP-i me certifikatë në të cilën tregohet kategoria, lënda/profili, cikli, si edhe vlerësimi me shkronjë i shoqëruar me përshkrim.

Neni 29

Procedura e ankimit

(Ndryshuar shkronjat “a” dhe “b” të pikës 1 dhe shkronjat “a” dhe “ç” të pikës 2 me udhëzimin nr. 6, datë 21.1.2025)

1. Për dosjen:
 - a) kandidati ka të drejtë të ankohet nëpërmjet portalit e-Albania, në formularin e shërbimit përkatës, brenda 3 (tri) ditëve nga hedhja në sistem e pikëve të vlerësimit të dokumentacionit nga Komisioni;
 - b) titullari i ZVAP-së shqyrton ankimin dhe ngarkon përgjigjen me nënshkrim elektronik nëpërmjet portalit e-Albania brenda pesë ditëve nga data e ankimit. Në rast të pranimit të plotë ose të pjesshëm të ankimit, pikët e rivlerësuar hidhen në sistem nga titullari;
 - c) përgjigja e titullarit është përfundimtare.
2. Për testimin e informatizuar:

a) kandidati ka të drejtë të ankohet në QSHA, nëpërmjet portalit e-Albania, lidhur me rezultatin e testimit të informatizuar, brenda 3 (tri) ditëve nga marrja e rezultatit të testimit të informatizuar;

b) QSHA-ja dërgon ankimin e kandidatit në ASCAP, vetëm në rastet kur ankimi lidhet me përmbajtjen e pyetjeve të testit të informatizuar, brenda pesë ditëve pune.

c) ASCAP-i shqyrton ankimin dhe i kthen përgjigje QSHA-së për ankimin e kandidatit, brenda 5 ditëve pune.

ç) QSHA-ja i kthen përgjigje kandidatit mbi ankimin nëpërmjet portalin e-Albania, brenda 5 (pesë) ditëve pune.

Neni 30

Konflikti i interesit

1. Hartuesit e fondit të pyetjeve nuk duhet të jenë autorë të teksteve shkollore dhe të librave ndihmës për nxënësit (përveç atyre që botohen nga institucionet vartëse të MAS-it).

2. Hartuesit e fondit të pyetjeve, anëtarët e komisionit të testimit të informatizuar të autorizuar nga ASCAP-i, anëtarët e komisionit të vlerësimit të orëve mësimore të hapura ose të projekteve kurrikulare nuk duhet të kenë lidhje familjare me kandidatin (bashkëshort/bashkëshorte/bashkëjetues, prind, vëlla/motër, fëmijë në moshë madhore, prindër të bashkëshortit/bashkëshortes/bashkëjetuesit).

3. Hartuesit e fondit të pyetjeve, anëtarët e komisionit të testimit të informatizuar të autorizuar nga ASCAP-i, anëtarët e komisionit të vlerësimit të orëve mësimore të hapura ose të projekteve kurrikulare nënshkruajnë deklaratën e konfliktit të interesit në institucionet përkatëse.

KREU VII

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 31

Aspekte financiare

1. Shpenzimet për hartuesit e fondit të pyetjeve, anëtarët e komisioneve të testimit të informatizuar mbulohen nga ASCAP-i.

2. Shpenzimet për vlerësuesit e orëve mësimore të hapura dhe të projekteve kurrikulare mbulohen AKAP-i ose DRAP-ja, ose ZVAP-ja.

Neni 32

Objekti i inspektimit

1. Procedurat e vlerësimit të dosjeve nga ZVAP-të, procesverbalet për kryerjen dhe vlerësimin e orëve mësimore të hapura ose të projekteve kurrikulare dhe monitorimi i procesit të kualifikimit përfshihen në platformat e inspektimit të ASCAP-it, AKAP-it dhe DRAP-ve.

2. Planifikimet dhe vlerësimet e orëve mësimore të hapura dhe projektet kurrikulare ruhen në mjedisin e ZVAP-së ose të institucionit arsimor për një vit kalendarik.

3. Dokumentacioni i krijuar gjatë zbatimit të procedurave të përcaktuara në këtë udhëzim është objekt i inspektimit të institucioneve të autorizuar, sipas akteve ligjore dhe nënligjore për arsimin parauniversitar.

Neni 33

Dispozita kalimtare

(Shtuar paragraf me udhëzimin nr. 6, datë 21.1.2025)

Zbatimi i këtij udhëzimi fillon në procesin e kualifikimit të vitit shkollor 2024–2025 dhe procedurave të kualifikimit u nënshtrohen detyrimisht të gjithë mësuesit, të cilët, deri më 31 dhjetor të vitit paraardhës, plotësojnë kushtet për vjetërsinë e punës në arsim, si më poshtë:

a) Për kategorinë e kualifikimit “Mësues i kualifikuar”:

i. 3–5 vjet punë si mësues;

ii. të ketë 30 kredite zhvillim profesional;

iii. vlerësimin e performancës nga drejtori i shkollës “Mirë” ose “Shumë mirë”.

b) Për kategorinë e kualifikimit “Mësues specialist”:

i. 8–10 vjet punë si mësues, nga të cilat 5 vjet punë si mësues i kualifikuar;

ii. të ketë 50 kredite zhvillim profesional;

iii. vlerësimin e performancës nga drejtori i shkollës “Mirë” ose “Shumë mirë”.

c) Për kategorinë e kualifikimit “Mësues mjeshtër”:

i. 15–20 vjet punë si mësues, nga të cilat 7 vjet punë si mësues specialist;

ii. të ketë 70 kredite zhvillim profesional;

iii. vlerësimin e performancës nga drejtori i shkollës “Shumë mirë”.

Kërkesat dhe procedurat administrative, që janë në proces shqyrtimi nga institucionet kompetente, lidhur me procedurën e aplikimit për kualifikimin e punonjësit arsimor dhe/ose e ankimit, trajtohen dhe zhvillohen sipas dispozitave në fuqi të këtij udhëzimi, në kohën e paraqitjes së tyre.

Neni 34

Hyrja në fuqi

1. Udhëzimi nr. 2, datë 8.2.2023, i ministrit të Arsimit dhe Sportit, “Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të punonjësve arsimorë”, shfuqizohet.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar, Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, Qendra e Shërbimeve Arsimore, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar, zyrat vendore të arsimit parauniversitar dhe institucionet e arsimit parauniversitar.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESMINISTËR I ARSIMIT
DHE SPORTIT

Nina Guga

SHTOJCA NR. 1
FORMATI I INSTRUMENTIT PËR VLERËSIMIN E ORËS SË HAPUR MËSIMORE “MËSUES I KUALIFIKUAR”

Nr.	Treguesit e cilësisë	PËRSHKRUESIT	Pikët total për secilin përshkrues	Nivelet e vlerësimit				Pikët e fituara
				1	2	3	4	
1.	Planifikimi i orës mësimore të hapur (6 pikë)	Mësuesi ka planifikuar të gjitha komponentët e orës së mësimin në mënyrë koherente dhe në përmbushje të rezultateve të të nxënës	3 pikë	0	1	2	3	
		Mësuesi ka planifikuar për temën mësimore qasje të reja inovative që lidhen me demonstrimin e kompetencave të të nxënës gjatë gjithë jetës, përveç kompetencave lëndore	3 pikë	0	1	2	3	
2.	Mjedisi i të nxënës (6 pikë)	Mësuesi ka krijuar një klimë pozitive, ku nxënësit trajtohen në mënyrë të barabartë, shprehin lirshëm mendimet e tyre, respektojnë njëri-tjetrin dhe pranojnë mendimin ndryshe	3 pikë	0	1	2	3	
		Mësuesi angazhon dhe përfshin të gjithë nxënësit, duke i nxitur dhe motivuar të ndërmarrin iniciativë, i dëgjon me vëmendje dhe u jep përgjigje me kujdes	3 pikë	0	1	2	3	
3.	Metodat mësimore (6 pikë)	Mësuesi përdor metoda që nxisin mendimin kritik, krijues, që nxisin diskutimin (apo debatin), origjinalitetin.	3 pikë	0	1	2	3	
		Mësuesi drejton pyetje të niveleve dhe llojeve të ndryshme dhe nxit nxënësit të bëjnë pyetje gjatë orës së mësimin	3 pikë	0	1	2	3	
4.	Vlerësimi dhe arritjet e nxënësve (6 pikë)	Mësuesi vlerëson për të identifikuar nevojat për përmirësim të nxënësit dhe lehtëson procesin e nxënies së tij duke përdorur teknika të ndryshme vlerësimi, vetëvlerësimi apo vlerësimi të nxënësve nga nxënësit sipas niveleve të arritjes	3 pikë	0	1	2	3	
		Mësuesi angazhon nxënësit me detyra të diferencuara sipas stileve të të nxënës dhe nevojave të nxënësve	3 pikë	0	1	2	3	
5.	Përdorimi i mjeteve (6 pikë)	Mësuesi përdor mjetet mësimore didaktike për temën mësimore	3 pikë	0	1	2	3	
		Mësuesi përdor mjete e për të zhvilluar aftësitë e të nxënësve	3 pikë	0	1	2	3	
		Vlerësimi i përgjithshëm	30 pikë gjithsej	Pikët e fituara nga mësuesi				

Kandidati mësues

Drejtuesi i shkollës

Mësuesi koordinator për sigurimin e cilësisë/Kryetar i ekipit lëndor

SHTOJCA NR. 2
FORMATI I INSTRUMENTIT PËR VLERËSIMIN E ORËS SË HAPUR MËSIMORE “MËSUES SPECIALIST”

Nr.	Treguesit e cilësisë	PËRSHKRUESIT	Pikët total për secilin përshkrues	Nivelet e vlerësimit				Pikët e fituara
				1	2	3	4	
1.	Planifikimi i orës mësimore të hapur (6 pikë)	Mësuesi ka planifikuar të gjitha komponentët e orës së mësimin në mënyrë koherente dhe në përmbushje të rezultateve të të nxënës	3 pikë	0	1	2	3	
		Mësuesi ka planifikuar për temën mësimore qasje të reja inovative që lidhen me demonstrimin e kompetencave të të nxënës gjatë gjithë jetës, përveç kompetencave lëndore	3 pikë	0	1	2	3	
2.	Mjedisi i të nxënës (6 pikë)	Mësuesi ka krijuar një klimë pozitive, ku nxënësit trajtohen në mënyrë të barabartë, shprehin lirshëm mendimet e tyre, respektojnë njëri-tjetrin dhe pranojnë mendimin ndryshe	3 pikë	0	1	2	3	
		Mësuesi angazhon dhe përfshin të gjithë nxënësit duke i nxitur dhe motivuar të ndërmarrin iniciativë, i dëgjon me vëmendje dhe u jep përgjigje me kujdes	3 pikë	0	1	2	3	
3.	Metodat mësimore (6 pikë)	Mësuesi përdor metoda që nxisin mendimin kritik, krijues, që nxisin diskutimin (apo debatin), origjinalitetin	3 pikë	0	1	2	3	
		Mësuesi drejton pyetje të niveleve dhe llojeve të ndryshme dhe nxit nxënësit të bëjnë pyetje gjatë orës së mësimin	3 pikë	0	1	2	3	
4.	Vlerësimi dhe arritjet e nxënësve (6 pikë)	Mësuesi vlerëson për të identifikuar nevojat për përmirësim të nxënësit dhe lehtëson procesin e nxënies së tij, duke përdorur teknika të ndryshme vlerësimi, vetëvlerësimi apo vlerësimi të nxënësve nga nxënësit sipas niveleve të arritjes	3 pikë	0	1	2	3	
		Mësuesi angazhon nxënësit me detyra të diferencuara sipas stileve të të nxënës dhe nevojave të nxënësve	3 pikë	0	1	2	3	
5.	Përdorimi i mjeteve (6 pikë)	Mësuesi përdor mjetet mësimore didaktike për temën mësimore	3 pikë	0	1	2	3	
		Mësuesi përdor mjete e për të zhvilluar aftësitë e të nxënësve	3 pikë	0	1	2	3	
		Vlerësimi i përgjithshëm	30 pikë gjithsej	Pikët e fituara nga mësuesi				

Kandidati mësues

Drejtuesi i shkollës

Drejtuesi i rrjetit profesional/Përfaqësuesi i ZVAP-së

SHTOJCA NR. 3
FORMATI I INSTRUMENTIT PËR VLERËSIMIN E PROJEKTT KURRIKULAR “MËSUES SPECIALIST”

Nr.	Treguesit e cilësisë	PËRSHKRUESIT	Pikët total për secilin përshkrues	Nivelet e vlerësimit				Pikët e fituara
				1	2	3	4	
1.	Aftësitë kërkimore/hulumtuese - Demonstrimi i tyre (12 pikë)	Demonstrim i aftësive hulumtuese, kërkimore, krijuese	3 pikë	0	1	2	3	
		Bashkëpunimi në grup; grupi orientohet dhe drejtohet vetë	3 pikë	0	1	2	3	
		Fokusimi te detyra e dhënë	3 pikë	0	1	2	3	
		Përdorimi i informacioneve të përshtatshme për detyrën	3 pikë	0	1	2	3	
2.	Analiza dhe interpretimi i të dhënave: Zgjedh dhe zbaton teknika të përshtatshme (10 pikë)	Përdorimi gjatë gjithë projektit i teknikave të përshtatshme, efektive, krijuese, origjinale	3 pikë	0	1	2	3	
		Analiza, interpretimi, zgjidhja nuk përmban gabime shkencore	3 pikë	0	1	2	3	
		Përdorimi i skemave ose i diagrameve të ndryshme	4 pikë	0-1	2	3	4	
3.	Aftësitë e prezantimit: Prezanton në mënyrë efektive rezultatet e projektit (18 pikë)	Ka krijimtari dhe organizimi i materialit të krijon lehtësi leximi, dëgjimi dhe të kuptuari	6 pikë	0-1	2-3	4-5	6	
		Rezultatet e projektit janë origjinale dhe prezantohen qartë	6 pikë	0-1	2-3	4-5	6	
		Vlerësimi ndikon pozitivisht në progresin e nxënësit	6 pikë	0-1	2-3	4-5	6	
		Vlerësimi i përgjithshëm	40 pikë gjithsej	Pikët e fituara nga mësuesi				

Kandidati mësues

Drejtuksi i shkollës

Mësuesi koordinator për sigurimin e cilësisë /Kryetari i ekipit lëndor

SHTOJCA NR. 4
FORMATI I INSTRUMENTIT PËR VLERËSIMIN E PROJEKTT KURRIKULAR “MËSUES MJESHTËR”

Nr.	Treguesit e cilësisë	PËRSHKRUESIT	Pikët total për secilin përshkrues	Nivelet e vlerësimit				Pikët e fituara
				1	2	3	4	
				Pikët sipas niveleve të vlerësimit				
1.	Aftësitë kërkimore/hulumtuese - Demonstrimi i tyre (20 pikë)	Demonstrim i aftësive hulumtuese, kërkimore, krijuese	4 pikë	0-1	2	3	4	
		Bashkëpunimi në grup; grupi orientohet dhe drejtohet vetë	4 pikë	0-1	2	3	4	
		Mbledhja e shumëllojshmërisë së informacioneve	4 pikë	0-1	2	3	4	
		Fokusimi te detyra e dhënë	4 pikë	0-1	2	3	4	
		Përdorimi i informacioneve të përshtatshme për detyrën	4 pikë	0-1	2	3	4	
2.	Analiza dhe interpretimi i të dhënave: Zgjedh dhe zbaton teknika të përshtatshme (20 pikë)	Përdorimi gjatë gjithë projektit i teknikave të përshtatshme, efektive, krijuese, origjinale	6 pikë	0-1	2-3	4 -5	6	
		Analiza, interpretimi, zgjidhja nuk përmban gabime shkencore	7 pikë	0-1	2-3	4 -5	6-7	
		Përdorimi i skemave ose diagrameve të ndryshme	7 pikë	0-1	2-3	4 -5	6-7	
3.	Aftësitë e prezantimit: Prezanton në mënyrë efektive rezultatet e projektit (30 pikë)	Ka krijimtari dhe organizimi i materialit të krijon lehtësi leximi, dëgjimi dhe të kuptuari	10 pikë	0-2	3-5	6-8	9-10	
		Rezultatet e projektit janë origjinale dhe prezantohen qartë	10 pikë	0-2	3-5	6-8	9-10	
		Vlerësimi ndikon pozitivisht në progresin e nxënësit	10 pikë	0-2	3-5	6-8	9-10	
		Vlerësimi i përgjithshëm	70 pikë gjithsej	Pikët e fituara nga mësuesi				

Kandidati mësues

Drejtuuesi i shkollës

Drejtuuesi i rrjetit profesional/Përfaqësuesi i ZVAP-së

SHTOJCA NR. 5
FORMATI PËR VLERËSIMIN E DOSJËS SË KANDIDATIT PËR KUALIFIKIMIN
(Ndryshuar togfjalësh në shkronjën "a" dhe shkronja "b" me udhëzimin nr. 6, datë 21.1.2025; ndryshuar shkronja "b" me udhëzimin nr. 12, datë 24.2.2025)

a)	Dëshmi të njohjes së gjuhës/ve të huaja (jo mësues të gjuhëve të huaja): 1. Gjuhë e huaj e mbrojtur në IAL-të publike: 7 pikë 2. Gjuhë e huaj e mbrojtur me testim ndërkombëtar nivel A1: 5 pikë 3. Gjuhë e huaj e mbrojtur me testim ndërkombëtar nivel A2: 6 pikë 4. Gjuhë e huaj e mbrojtur me testim ndërkombëtar nivel B1: 7 pikë 5. Gjuhë e huaj e mbrojtur me testim ndërkombëtar nivel B2: 8 pikë 6. Gjuhë e huaj e mbrojtur me testim ndërkombëtar nivel C1: 9 pikë 7. Gjuhë e huaj e mbrojtur me testim ndërkombëtar nivel C2: 10 pikë Si gjuhë e huaj e mbrojtur llogaritet edhe rasti kur gjuha e huaj është e mbrojtur në kuadër të përfundimit të studimeve të larta të ciklit të dytë dhe është brenda afatit të vlefshmërisë, sipas legjislacionit përkatës. Pavarësisht, se kandidati mund të ketë disa gjuhë të huaja të mbrojtura, në këtë rubrikë <i>nuk mund t'i llogariten më shumë se 10 pikë në vlerësimin e dosjes.</i> Në rast se kandidati ka mbrojtur të njëjtën gjuhë të huaj në dy institucione të ndryshme, do t'i llogariten pikë vetëm për një dëshmi.	5–10 pikë
b)	Diplomë: Diplomë e ciklit të dytë master me 60-120 kredite ECTS, diplomat e ciklit të tretë "Master ekzekutiv" ose të barasvlershme me to me 60–120 kredite ECTS, doktoratë të fituar në fushën e edukimit, të drejtimit të arsimit dhe/ose që lidhet me profilin përkatës. Kjo lloj diplome nuk përfiton pikë shtesë nëse vlen si kriter shkollimi për profesionin e mësuesit. 1. Diploma me 60–90 kredite, vlerësohen me 8 pikë. 2. Diploma me 120 kredite, vlerësohen me 9 pikë. 3. Doktoraturë, vlerësohet me 10 pikë.	8–10 pikë
c)	Pikët e krediteve: a) të paktën 50% e krediteve të ZHVP-së duhet të jenë të lidhura me fushën e profilin që mbulon: 2 pikë b) mbi 50% e krediteve të ZHVP-së duhet të jenë të lidhura me fushën e profilin që mbulon: 3 pikë c) të paktën 70% e krediteve të ZHVP-së duhet të jenë në aktivitete të drejtpërdrejta: 2 pikë d) mbi 70% e krediteve të ZHVP-së duhet të jenë në aktivitete të drejtpërdrejta: 3 pikë e) 80% e krediteve totale të ZHVP-së duhet të jenë nga aktivitetet e akredituara në nivel kombëtar: 3 pikë f) mbi 80% e krediteve totale të ZHVP-së duhet të jenë nga aktivitetet e akredituara: 4 pikë	2–10 pikë